



Bazuar në nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 3.3) të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, si dhe nenin 615 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, bën:

Shpallje të konkursit për marrëveshje për shërbime të veçanta

<i>Emri i Institucionit:</i>	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM)
<i>Njësia Organizative:</i>	Departamentit i TI-së
<i>Titulli i punës:</i>	Zyrtar i TI-së për përkrahje
<i>Numri i referencës:</i>	KPMM/01/2020/M.SH.V.
<i>Tarifa e shërbimit:</i>	423.47 € (bruto)
<i>Raporton te:</i>	Kryesuesi i Departamentit të TI-së
<i>Lloji i kontratës:</i>	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
<i>Kohëzgjatja e kontratës:</i>	Gjashtë (6) muaj
<i>Orari i ofrimit të shërbimit:</i>	I plotë
<i>Numri i ekzekutuesve:</i>	1 (një)
<i>Vendi:</i>	Prishtinë
<i>Data e përafërt e fillimit:</i>	01.02.2020

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Te bëj riparimin e harduerit dhe softuerit dhe pajisjeve tjera te TI-se,
- Aftësi efektive të komunikimit dhe aftësi për të bashkëvepruar në mënyrë profesionale me klientët dhe stafin, aftësi për të punuar në mënyrë produktive në ekipe si zgjidhës i mirë i problemeve
- Njohuri te konsiderueshme në mbrojtje kundër viruseve te sistemeve_Antivirus.
- Riparues i rrjeteve, sistemeve, dhe aplikacionet për të identifikuar dhe përmirësuar mosfunksionimet dhe probleme të tjera operationale.
- Instalimi i sistemeve operative dhe aplikacione të tjera të nevojshme për punë normale të desktopit, ndihmë në çështjet e pazgjidhura të Helpdesk-ut.
- Ofroj mbështetje të nivelit të parë për printerët e rrjetit dhe makinat fotokopjuese të rrjetit / dhe pajisje tjera të veçanta.
- Koordinoj punën dhe te bëj riparime në laptop dhe kompjuterë.
- Ripërshkruaj sistemet sipas nevojës.
- Mirëmbaj sigurinë e zonës së Help Desk-ut
- Detyra tjera të ngjashme, që i jep Kryesuesi i TI-së, dhe sipas nevojës.

Shkathtësitë e kërkuara: (*Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës*)

- Diplomë universitare (minimumi bachelor në shkencat kompjuterike) si dhe 2 vite përvojë pune profesionale
- Certifikimet dhe trajnime të përfunduara në fushën e MCP dhe A+ apo CCNA janë përparësi.
- Përvoja dhe LAN dhe WAN dhe telefoni janë përparësi
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Të jetë i aftë të përballojë dhe të organizojë punën;
- Aftësi në punë nën presion dhe fleksibilitet;
- Të jete person me integritet të lartë personal dhe moral;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve të Office dhe sistemit operative Windows 10.

<i>Emri i Institucionit:</i>	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM)
<i>Njësia Organizative:</i>	Departamenti Ligjor
<i>Titulli i punës:</i>	Zyrtar Ligjor
<i>Numri i referencës:</i>	KPMM/02/2020/M.SH.V.
<i>Tarifa e shërbimit:</i>	423.47 € (bruto)
<i>Raporton te:</i>	Kryesuesi i Departamentit Ligjor
<i>Lloji i kontratës:</i>	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
<i>Kohëzgjatja e kontratës:</i>	Gjashtë (6) muaj
<i>Orari i ofrimit të shërbimit:</i>	I plotë
<i>Numri i ekzekutuesve:</i>	1 (një)
<i>Vendi:</i>	Prishtinë
<i>Data e përafërt e fillimit:</i>	01.02.2020

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranimi i aplikacioneve për hulumtim, shfrytëzim dhe leje të veçanta, ofrimi i mbështetjes juridike për kompanitë;
- Përgatitja e raporteve për aplikacionet, hulumtim, shfrytëzim dhe leje të veçanta;
- Përgatitja e aktvendimeve dhe shkresave tjera që dalin nga mbledhja e Bordit;
- Përgatitja e aktvendimeve për mospërputhshmëri;
- Kontrollon sigurimet për palët e treta dhe Garancionet bankare për licenca dhe leje;
- Përgatitja e Kallëzimeve Penale dhe Gjobjave administrative;
- Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda institucionit për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit;
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Shkathtësitë e kërkua: *(Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)*

- Diplomë universitare në Fakultetin Juridik si dhe 2 vite përvojë pune profesionale
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Të jetë i aftë të përballojë dhe të organizojë punën;
- Aftësi në punë nën presion dhe fleksibilitet;
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Exel, Power Point; Access)
- Posedimi i patentshoferit është i dëshirueshëm

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë konkurs:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 (paragrafi 4) të Ligjit nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nenin 63 (paragrafi 3.3) të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Adresa: Rr. "Armend Daci", Nr. 1, 10000, Prishtinë ose mund të shkarkohen në ueb-faqen: <http://www.kosovo-mining.org>

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni zyrën e Burimeve Njerëzore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në tel. 038 240 252 / 202, prej orës 8:00 – 16:00.

Konkursi mbetet i hapur **8 ditë kalendarike**, nga dita e publikimit **17.01.2020** deri më: **24.01.2020**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda ditëve sa shpallja mbetet e hapur, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin, dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës, për të cilin konkurrohet.

Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen!

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit dhe emailit. Ata janë të obliguar t'i sjellin me vete dokumentet origjinale për kualifikimet dhe trajnimet e kryera, për verifikim para komisionit intervistues.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.